




Arrestohen tre persona për grabitje të armatosur në Istog

KRONIKA | March 31, 2022 - 10:21

SHPËRNDAJE: [f](#) [t](#)

Policia e Kosovës ka njoftuar se ka arrestuar tre persona në Istog, të cilët dyshohen se më 26 mars kishin kryer një grabitje të armatosur.

Sipas njoftimit të PK-së, rasti kishte ndodhur më 26.03.2022, rreth orës 16:00, në fshatin Suhogerll të Istogut, raporton Zeri.info.

“Policia është njoftuar se në fshatin Suhogerll - Istog, tre (3) persona të maskuar dhe të armatosur kanë ndaluar veturën, e cila ishte duke qarkulluar në atë rrugë, të dyshuarit nën kërcënimin e armës kanë kërkuar që viktimat, njëri nga ta i mitur, të largohen nga automjeti. Viktimat janë larguar nga automjeti, ndërsa nga të dyshuarit nga viktimat kanë marrë: nëntëqind (900) euro, dy (2) telefona, të cilët i kanë kthyer në vendin e ngjarjes dhe veturën, e cila është gjetur dy (2) kilometra nga vendi i ngjarjes, e braktisur”, thuhet në njoftimin e PK-së.


Policia bën të ditur se rastit ju kanë përgjigjur njësitet relevante nga Stacioni Policor Istog dhe Njësi i Sektorit Rajonal për Hetime - DRP Pejë, ku pas një pune intensive nga hetuesit e Sektorit Rajonal për Hetime, më 30.03.2022, është arritur të identifikohen dhe arrestohen tre të dyshuarit e këtij rasti.

“Më qëllim të gjetjes së provave është bërë bastisja e tri (3) lokacioneve, ndërsa në njërin nga lokacionet janë gjetur dhe konfiskuar: dy (2) armë të gjata tre karikatorë”, thuhet në njoftim.

Sipas njoftimit të PK-së, thuhet se pas konsultimit me prokurorin kompetent, të dyshuarit janë intervistuar dhe me urdhër të tij ndaj dy (2) të dyshuarve është caktuar masa e ndalimit policor prej 48 orësh, ndërsa njëri nga të dyshuarit është liruar në procedurë të rregullt. /Zëri



Të rekomanduara



Kryetari i Malishevës viziton vendin ku vdiqën...

March 31, 2022

Aktakuzë kundër një shqiptari me vendbanim në Beograd për masakrën e Izbicës


KRONIKA | March 29, 2022

Vazhdon përhapja e parave të falsifikuara, pesë raste në Prishtinë e tri në Gjakovë

KRONIKA | March 29, 2022

20-vjeçari nga Ferizaj rrahu nënën e tij, policia e arreston

KRONIKA | March 29, 2022



Dy të vdekur në një aksident trafiku në...

March 31, 2022

Prishtinasja rrah nënën, policia e arreston

KRONIKA | March 29, 2022

Theren me thikë tre persona në Prishtinë, dërgohen në QKUK

KRONIKA | March 29, 2022

Raportohet për dhunë në një familje në Shtime, policia sekuestron edhe armë

KRONIKA | March 28, 2022

Më të lexuarat



KRONIKA | March 29, 2022

Aktakuzë kundër një shqiptari me vendbanim në Beograd për masakrën e Izbicës



KRONIKA | March 29, 2022

Policia jep detaje pas aksidentit ku vetura goditi 4 vajza në Prishtinë



KRONIKA | March 30, 2022

Nëna e bën për spital vajzën e saj të mitur në Viti



KRONIKA | March 31, 2022

Dy të vdekur në një aksident trafiku në Malishevë



KRONIKA | March 29, 2022

Vazhdon përhapja e parave të falsifikuara, pesë raste në Prishtinë e tri në Gjakovë



KRONIKA | March 30, 2022

Arrestohet 37-vjeçari për mashtrim në Ferizaj